

MINISTRIA E DREJTËSISË

DITARI MUJOR



QERSHOR 2024

MANJA JEP LAJMIN E MIRË: RRITEN PAGAT PËR POLICINË E BURGJEVE, PËRFITOJNË 3430 POLICË NË SISTEM



Në një dalje publike pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave, Manja dha lajmin e mirë për rritjen e pagave për 3430 punonjës të strukturave të Policisë së Burgjeve. Nga kjo rritje, përfitojnë policët që janë pjesë e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, por edhe ata në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, duke pëmbushur një premtim të qeverisë shqiptare për rritjen e pagës mesatare në administratë në vlerën 900 euro.



MINISTRIA E DREJTËSISË PËRMBYLL KUALIFIKIMIN PËR PËRKTHYESË ZYRTARË, 202 TË RINJ TË TALENTUAR GATI PËR TË DHËNË KONTRIBUTIN E TYRE

Procesi i kualifikimit për përkthyesit zyrtarë është përmbyllur me sukses! Armatës së përkthyesve zyrtarë i janë bashkuar 202 të rinj të talentuar në 11 gjuhë të huaja. Ata do të japin kontributin e tyre të çmuar në përparimin e proceseve integruese dhe në plotësimin e nevojave të sistemit gjyqësor. Përgëzime të sinqerta të gjithë fituesve!

PROVIMI PËR GRADAT, MANJA: NJË STANDARD I RI PËR NDËRTIMIN E KARRIERS NË SISTEMIN PENITENCIAR

Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja përshëndeti provimin e zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për avancimin në grada të policisë së burgjeve. Për herë të parë, në procesin e vlerësimit u përdor teknologjia për të garantuar transparencë maksimale. Në përfundim të procesit Manja u shpreh: "Transparencë dhe meritokraci në gradë – ky është standardi që u vendos në Pallatin e Kongreseve, ku skantroni vendos!



Një standard që e kthen përfundimisht në sistem karriere punën në Policinë e Burgjeve! Sot, 673 punonjës policie të gradës inspektor konkurrojnë për 353 grada kryeinspektor dhe u uroj suksese!"



DIPLOMIMI I MAGJISTRATËVE TË RINJ, POROSIA E MINISTRIT TË DREJTËSISË PËR TA

Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të magjistratëve të rinj, të cilët nisin karrierën në sistemin e drejtësisë. Duke iu referuar magjistratit të ri Xhulio Doku, i cili u rendit i pari në gjeneratën që u diplomua, me citimin e një figurë evropiane të GJEDNJ, se “Legjitimiteti i vendimeve tona i ka rrënjët te

besimi i publikut tek drejtësia”!, Manja përcolli mesazhin e tij për brezin e ri të magjistratëve: “Rrokni dhe bëjeni moton e punës tuaj si magjistratë këtë thënie, që i ka rrënjët te përvoja e një gjyqtari që dikur e ka nisur karrierën me ëndrra si tuajat sot! Suksese!”



MINISTRI TAKON AVOKATEN E POPULLIT TË AZERBAJXHANIT: FORCOJMË BASHKËPUNIMIN MES DY VENDEVE

Ministri Manja takoi në Ministrinë e Drejtësisë, Avokaten e Popullit dhe Komisioneren për të Drejtat e Njeriut të Azerbajxhanit (Ombudsman), znj. Sabina Aliyeva. Në takim dy-palësh u diskutua si dy vende mike mbi thellimin e bashkëpunimit midis dy Avokatëve të Popullit dhe rolin e pazëvendësueshëm që kanë në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut!



MINISTRIA E DREJTËSISË PJESË E MINISTERIALIT PËR ANËTARËSIMIN E BALLKANIT PERËNDIMOR NË BE: ECURIA DHE SFIDAT E REFORMËS NË DREJTËSI

Ministria e Drejtësisë ishte pjesë e konferencës Ministeriale për Negociatat e Anëtarësimit të Vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, që u mbajt në Sarajevë përgjatë datave 26-28 Qershor 2024. Ministria e Drejtësisë u përfaqësua nga zëvendësministri z. Tedi Dobi, i cili në fjalën e tij prezantoi punën e bërë në reformimin e drejtësisë në Shqipëri dhe masat e ndërmarra nga qeveria shqiptare për rritjen e integritetit të funksionarëve publikë, duke e vlerësuar si një hap kyç në procesin e integritetit në BE.

